

LEKSIONI 3

I. NJËSIA SINTAKSORE E FJALISË

1. *Kuptimi dhe përkufizimi i saj.*
2. *Mjetet e lidhjes së fjalëve në sintagma dhe në fjali.*
3. *Llojet e lidhjeve sintaksore në fjali*
4. *Klasifikimi i fjalive*
5. *Gjymtyrëzimi aktual i fjalisë*
6. *Llojet e fjalive sipas kumtimit:*

1. Kuptimi dhe përkufizimi i fjalisë.

Fjalja është njësia themelore e sintaksës.

Ajo është e aftë të na bëjë të ditur diçka nga realiteti.

Edhe fjala është njësi themelore e gjuhës, e cila na lidh me një koncept nga realiteti, por njeriu nuk mund të komunikojë vetëm fjalë, pa i lidhur ato në fjali sipas rregullave të gjuhës që përdor.

Kurse, me fjalinë, gjuha realizon funksionet e saj kryesore, si,

- Funksionin komunikativ,
- Funksionin shprehës,
- Funksionin njohës,
- Funksionin e transmetimit të mesazheve etj..

Çdo gjykim shprehet me fjali, po jo çdo fjali shpreh gjykim. Gjykim shprehin fjalitë dëftore, kurse fjalitë e tjera, si: nxitëse, pyetëse, dëshirore, nuk mund të shprehin gjykime.

Gjykimi ka gjithmonë strukturë dyshe me **subjekt** dhe **predikat**, kurse fjalia mund të ketë vetëm njërin nga grupet, atë emëror ose foljor, që përfaqësojnë kryefjalën dhe kallëzuesin.

Paraqitur me simbole shkronjash, këta përbërës të gjykimit dhe të fjalisë janë:

Studenti mëson.



S + **P** (përbërës të gjykimit)

Kr. + **Ka.** (përbërës të fjalisë)

Fjala është njësi gramatikore që i ka të dyja planet :

- planin e shprehjes,
- planin e përmbajtjes.

Për të përcaktuar tiparet e fjalisë, duhet të kemi parasysh pikërisht lidhjen e pandashme midis këtyre dy anëve. Tiparet e fjalisë janë :

1. **Intonacioni i mbarimit.** Ai është i veçantë për çdo tip fjalie. Është një mjet i rëndësishëm i formimit të fjalisë, ai e bën një grup fjalësh fjali. Gjithashtu, ai e formon fjalinë edhe nga ana gramatikore. Me anë të intonacionit, edhe një fjalë e vetme mund të funksionojë si fjali, p.sh, *Zjarr!* e shqiptuar me intonacionin thirrës, kumton diçka se diku ka rënë zjarr. Por, po të shqiptojmë këtë fjalë, të marrë në vete, me të njëjtin intonacion, siç shqiptohet brenda një fjalie ku ajo përdoret, si p.sh, në fjalinë *Në pyll ka rënë zjarr*, asgjë s'kuptohet.
2. Një veçori gramatikore e përhershme e fjalisë është ***kallëzuesia*** (predikativiteti), që është shprehja gjuhësore e përmbajtjes së fjalisë. Folësi në çdo kuptim vendos një lidhje midis përmbajtjes së fjalisë që kumton dhe realitetit, duke e shprehur këtë përmbajtje si diçka reale ose joreale, si diçka të mundshme, të dëshiruar, të supozuar etj. Ai lidh, gjithashtu, kohën e shtjellimit të procesit në fjali në çastin e ligjërit.

Kategoria gramatikore e kallëzuesisë përbëhet nga

- kategoria e modalitetit sintaksor,
- kategoria e kohës sintaksore,

- kategoria e vetës sintaksore.

Që të tria këto shfaqen në kategorinë e kallëzuesisë së fjalisë dhe janë të lidhura ngusht me njëra tjetrën.

2. Mjetet e lidhjes së fjalëve në sintagma dhe në fjali.

Në gjuhën shqipe ka një sërë mjetesh me anën e të cilave shprehen lidhjet e fjalëve në sintagma dhe në fjali. Këto janë:

- trajtat e fjalëve ose eptimi (fleksioni) (mjete morfologjike),
 - fjalët shërbyese,
 - rendi i fjalëve (mjete sintaksore),
 - intonacioni (mjet fonetik).
- Me gjithë ndryshimet që kanë ndodhur gjatë kohës në sistemin e mjeteve morfologjike të shqipes, prapë ajo ka ruajtur një sistem të pasur lakimi e zgjedhimi që ndihmon për të zbuluar funksionin sintaksor të fjalëve.
 - Në fjalët shërbyese hyjnë parafjalët dhe lidhëzat. Parafjalët, sikurse thamë më lart, janë koka të sintagmave parafjalore, po njëkohësisht ato shërbejnë edhe si mjete lidhëse të këtyre sintagmave parafjalore me fjalët e tjera të fjalisë, duke vendosur raporte të ndryshme sintaksore me to. Nga ana tjetër, parafjalët vërtetë drejtojnë rasën e një emri para të cilit vendosen, po ato vetëm, s'mund të kryejnë funksionin e një gjymtyre fjalie, ato e kryejnë këtë funksion së bashku me fjalën që kanë pas dhe në këtë rast shërbejnë si një mjet i lidhjes së kësaj gjymtyre me fjalët e tjera të fjalisë.
 - Rendi i fjalëve luan rol të rëndësishëm në formimin e fjalisë. Por duhet dalluar rendi i fjalëve nga rendi i gjymtyrëve. Jo të gjitha fjalët që hyjnë në përbërje të fjalisë janë gjymtyrë të saj. Disa prej tyre kanë një vend të caktuar në fjali, të

ngulitur pranë fjalëve të tjera që duhen njohur. Rend të ngulitur të paravendosur kanë :

- pjesëzat mohuese para foljeve: **nuk** vjen,**s'foli**, **mos** fol etj.,
- trajtat e shkurtra dhe të bashkuara të përemrit vetor në rasat dhanore e kallëzore: **e** pashë, **i** fola, **ia** dhashë, duke mos **i** dhënë etj.,
- parafjalët para emrave, ndonjëherë edhe para ndajfoljeve : **në** shtëpi, **mbi** bankë, **prej** meje, **prej** afër etj..

- Mjetet e intonacionit janë mjete të rëndësishme për formimin e fjalisë dhe të njësive të tjera sintaksore. Me intonacion kuptojmë *melodiken* (ngritjen dhe uljen e zërit). Këto elemente janë të lidhura me njëri – tjetrin. Intonacioni është ai mjet që siguron lidhjen gramatikore e kuptimore të fjalisë, në mënyrë që ajo të shprehë një kumtim. Në bazë të intonacionit dallohet një fjalë e vetme nga një bashkim fjalësh që shprehin kumtim, si edhe kur kjo fjalë e vetme është fjali.

3. Llojet e lidhjeve sintaksore në fjali

Përveç lidhjes *me përshtatje*, *me drejtim* dhe *me bashkim* që veprojnë në një sintagmë, në fjali kemi edhe lidhje të tjera, që janë specifike për fjalinë. Ato janë:

- lidhja *kallëzuesore*,
- lidhja *e veçimit*,
- lidhja *e përfshirjes*,
- lidhja *me bashkërenditje*.

4. Klasifikimi i fjalive.

Fjalitë mund të klasifikohen ose grupohen:

1. për nga struktura
2. për nga llojet e kumtimit.

Për nga **STRUKTURA** fjalia mund të jetë e plotë ose e paplotë.

- Fjalia është e plotë kur i ka të dyja grupet kryesore, grupin emëror (grupi i kryefjalës) dhe grupin foljor (grupi i kallëzuesit).

Kur grupet përfaqësohen me vetëm nga një fjalë, ajo është dykryegjymtyrëshe dhe e pazgjeruar.

Kur dy grupet kryesore të saj, grupi i kryefjalës dhe grupi i kallëzuesit, dalin të zgjeruar me gjymtyrë të tjera, që quhen të dyta, fjalia është dykryegjymtyrëshe dhe e zgjeruar.

- Fjalia është e paplotë kur në të nuk janë shprehur njëra ose të dyja gjymtyrët kryesore ose edhe gjymtyrët e dyta të domosdoshme, që bëhen të qarta nga konteksti ose situata. Pra, në një grup fjalish të paplota gjymtyrët që nuk shprehen, i bën të qartë konteksti ose situata. P.sh, në fjalinë më poshtë folja-kallëzues nuk përmendet, se është thënë në fjalinë e parë, pra, bëhet e qartë nga konteksti:

- *Ku je emëruar ? - Në televizorin shtetëror.*

Në këtë mënyrë mund të mungojë kryefjala e shprehur në kontekst, si dhe gjymtyrë të dyta të ndryshme. Kurse në fjalinë:

- *Dy kafe të mesme, kamerier! - i tha ai sapo u ul në tavolinë,*

folja kallëzues mungon se bëhet e qartë nga situata, nga rrethanat në të cilat zhvillohet ligjërimi.

Në një grup fjalish të paplota, që në gramatikë quhen njëkryegjymtyrëshe, nuk ka mungesë gjymtyrësh që bëhen të qarta nga konteksti ose situata, por natyra

e gjuhës shqipe është e tillë që nuk ka nevojë të shprehet gjuhësisht njëra nga gjymtyrët kryesore. P.sh, në fjalitë:

Po shkoj.

Rri këtu.

Nisuni që tani.

S'më flihet,

nuk ka kryefjalë e nuk ka nevojë të ketë, sepse mbaresat vetore të foljeve e bëjnë të qartë folësin nga bashkëfolësi.

Nga pikëpamja e shprehjes së vetës, këto të fundit klasifikohen :

- ✓ në fjali pavetore, folja e së cilës është një folje pavetore që ka formën e vetës së tretë:

*Nuk më **rrihet** këtu*


- ✓ në fjali vetore, folja e së cilës shprehet me një nga vetat. Fjalitë vetore ndahen më tej në :

- fjali me vetë të përcaktuar : *Mos u nxitoni,*
- fjali me vetë të papërcaktuar : *Si të quajnë ?*
- fjali me vetë të përgjithësuar : *Atë njeri e gjen kudo.*

5. Gjymtyrëzimi aktual i fjalisë

Krahas analizës së fjalive në përbërës dhe zbërthimit të mëtejshëm të tyre deri në përbërësit fundorë, bëhet edhe një analizë tjetër e saj, që mbështetet në ngarkesën kumtesore, në aspektin komunikativ të saj. Ky quhet **zbërthim aktual i fjalisë** ose **gjymtyrëzim aktual** dhe mbështetet në mjete leksikore, leksiko- gramatikore dhe intonacionale. Për shembull, fjalia :

Shokët e mi kanë filluar stërvitjen në fushën sportive.



6. Llojet e fjalive sipas kumtimit:

Ligjërimi njerëzor është i larmishëm. Njerëzit komunikojnë me anë të gjuhës për të shkëmbyer informacione midis tyre, për të shprehur dëshirat, kërkesat ose për të pyetur për diçka. Duke u nisur nga kjo, sipas llojit të komunikimit, përmbajtjes dhe funksionit që kryejnë në ligjërim dallohen :

a. fjali dëftore, si :

Rrugët e Tuzit ishin plot me njerëz.

Zhurma e helikopterit u dëgjua përsëri.

b. fjali nxitëse, si :

Uluni te kjo karrige, ju lutem.

Afrohu dhe pak, pastaj ndalo.

Kthehuni nga rruga sa s'është vonë.

Mos shikoni të tjerët, po vihuni punës suaj.

c. fjali dëshirore, si :

Qofshi të gëzuar dhe të lumtur!

Të isha edhe unë me ata!

d. fjali pyetëse, si :

Sa mund të jetë ora?

Ku vete?

E? Si t'u duk?

Si i bëhet kësaj pune?

Fjalitë dëshirore e pyetëse, përveç fakteve reale, mund të shprehin edhe mundësi, pamundësi, supozim, pasiguri, domosdoshmëri etj.

- *Kjo dhembje e madhe s'durohet.* (pamundësi);
- *A kalohet këtej?* (mundësi);
- *Nga t'ia mbaj? Te kush të paraqitëm? Mos vallë e kanë dërguar kot këtu?* (pasiguri);
- *Do parë kjo punë. Nuk flitet kështu.* (domosdoshmëri);
- *Do të ketë shkuar në vend tjetër. A do të ketë ardhur se?* (supozim).

TIPAT E FJALIVE SIPAS KUMTIMIT

1. *Fjalitë dëftore*
2. *Fjalitë dëftore - thirrmore*
3. *Fjalitë dëshirore dhe nxitëse*
4. *Fjalitë pyetëse*

1. Fjalitë dëftore

Fjalitë që komunikojnë fakte të realitetit quhen fjali dëftore. Ato kumtojnë diçka reale që ka ndodhur, ndodh apo do të ndodhë. Me to folësi u bën të njohura të tjerëve njohuritë që ka, konstaton diçka, shpreh mendimet dhe gjykimet e veta. Këto fjali janë të zakonshme në të gjitha llojet e ligjërit, sidomos në letërsinë artistike, kur përshkruhet apo tregohet diçka, për shembull:

Orkestra vazhdonte t'i binte fanfarës së gëzueshme.

Në rrugëte Tuzit nuk frynte erë, kurse kalimtarët ishin tepër të rrallë atë pasdite vjeshte.

Nga llojet e tjera të fjalive, fjalitë dëftore dallohen nga

- ***intonacioni,***
- ***mënyra e foljes.***

Intonacioni i tyre është tregues dhe i qetë. Toni ulet në fund të fjalisë. Intonacioni varet nga vendi i fjalës që mban theksin logjik. Kur kjo fjalë është në fund të fjalisë, intonacioni është zbritës, sepse toni ngrihet te kjo fjalë, pastaj zbret. Kur fjala e theksuar është në fund, toni ngrihet në të


dhe intonacioni është ngjitës. Kur është në mes, intonacioni është normal, ai përfaqëson një lakore që ngritjen më të madhe e ka në mes, bie fjala:

Ty të takon kjo punë.

*Të takon **ty** kjo punë.*

*Kjo punë të takon **ty**.*

Me skemë, intonacioni i fjalive dëftore paraqitet kështu :



Folja e fjalisë dëftore është zakonisht në mënyrën dëftore, po mund të jetë edhe në habitore, kushtore ose në lidhore, kur fjalia është e nënrenditur, p.sh. :

Paskam qenë e hutuar atë çast.

Fjalitë dëftore përveç fakteve reale, mund të shprehin edhe kuptime të tjera modale, si: *mundësi (pamundësi), domosdoshmëri, supozim* etj. Dhe, në bazë të këtyre kuptimeve, ato marrin edhe emërtimet e tyre përkatëse. Kështu *fjalitë dëftore të mundësisë e të pamundësisë* tregojnë se një veprim a gjendje mund të realizohet ose mund të mos realizohet.

Këto fjali, në përgjithësi, dalin si të varura, po mund të dalin edhe të mëvetësishme e të bashkërenditura.

Kurse pamundësia shprehet me të njëjtat strukturanë formë mohore.

*Ai që **mund t'i jepte** gëzim gjithë vendit, si **të mos mund të përdorte** një grimë nga ai gaz për veten e vet?*

S'kishte vend ku të shtrihe këmbët.

2. Fjalitë dëftore - thirrmore

Fjalitë dëftore- thirrmore janë fjali në të cilat, përveç fakteve të ndryshme nga realiteti, kumtohet edhe qëndrimi afektiv (emocional) i folësit, shprehen ndjenjat e tij gjatë ligjëritimit.

Në këto fjali shprehen ndjenja të ndryshme, si: *gëzimi, kënaqësia, entuziazmi, hidhërimi, zemërimi, dëshpërimi* etj, ose qëndrime të ndryshme afektive të folësit, si: *habia, admirimi, ironia, përbuzja, frika* etj., p.sh. :

Qenke kthyer! – thirri ai.

Gjallë është! - klithi Adnani.

Qyqja ç'bëmë ne, qyqja!

Aty qenka rrëmuje e vërtetë! - u habita unë.

Uh, sa më trembe!

Si i mbake mend ti! -i tha tjetra.

Fjalitë dëftore-thirrmore karakterizohen nga dy tipare:

1. nga intonacioni i veçantë,
2. nga fjalë të veçanta thirrmore.

3. Fjalitë dëshirore dhe nxitëse

Fjalitë dëshirore dhe nxitëse janë fjali që *shprehin vullnetin e folësit*. Dëshira dhe nxitja për të bërë diçka janë dy forma të shprehjes së vullnetit të folësit, që në shumë raste janë aq pranë njëra tjetrës sa është vështirë t'i dallosh dhe t'i ndash. P.sh, kur i themi dikujt:

Më sill një gotë ujë,

shprehim në të njëjtën kohë një dëshirë tonën, dëshirën për të pirë një gotë ujë dhe një kërkesë në formë lutjeje ndaj dikujt që e njohim dhe jemi të sigurt se do ta realizojë kërkesën.

Pra, dëshira dhe nxitja, si forma të shprehjes së vullnetit, në shumicën e rasteve shprehen me forma të veçanta gjuhësore, dëshira me fjalitë dëshirore, nxitja me fjalinë nxitëse.

Por, siç e pamë edhe në shembullin më sipër, mund të gjejmë shprehje edhe brenda së njëjtës formë gjuhësore.

Midis fjalive dëshirore e nxitëse ka tipare të përbashkëta kuptimore e formale. Këto **tipare të përbashkëta** janë:

- Në të dyja këto raste shprehet vullneti i folësit,
- Shënojnë fakte joreale,
- Në të dy tipat përdoret shpesh mënyra lidhore.

Por **ka edhe dallime** të cilat qëndrojnë:

- Në shkallën e në natyrën e elementit vullnetshprehës, që përcakton përmbajtjen e kumtimit të dhënë prej tyre: te dëshiroret ai është më i dobët e më pak veprues sesa tek nxitëset, që është më i fuqishëm e veprues e merr formën e një thirrjeje për veprim.
- Në format mënyrore të foljeve: në dëshiroret tipike është mënyra dëshirore, të nxitëset përdoret mënyra urdhërore.

Eh. Tani të kishim lindur! Mos i besoni atij.

- Lëri dënglat. Bjeru drurëve shkurt, - tha Xhezoja

a. Fjalitë dëshirore

Fjalitë dëshirore shprehin një fakt të dëshiruar prej folësit. Ata shprehin vullnetin e folësit në *formë urimi, mallkimi* a të një dëshire tjetër. Në to hyjnë edhe fjalitë që shprehin *sharje, betime, përshëndetje*, etj.

Zakonisht dalin si dëshirore - thirrmore.

Si jothirrmore dalin ato që nga përdorimi i gjatë e i dendur janë kthyer në mënyra të thëni dhe nëformula të gatshme. Fjalitë dëshirore foljen kallëzues e kanë zakonisht në mënyrën dëshirore, por edhe në mënyrën lidhore, për shembull:

*Ah, **të isha** tani në shtëpinë time!*

*Në qafë **paçin** vetën e tyre, se ne u dolëm borxhi.*

*Kështu të gëzuar ju **pafsha** gjithmonë!*

***Të trashëgohen e të bëhen** edhe pleq.*

*Të zotin e shtëpisë e **paçim** sa malet!*

*M'**ubëfsh** burrë e m'**u bëfsh** trim!*

*E **marrtë djalli, e marrtë!** – mallkoi.*

***Plaçin** ata që s'na duan!*

b. Fjalitë nxitëse

Fjalitë nxitëse janë fjalitë që shprehin vullnet të folësit në formën e urdhrit, të propozimit, porosisë, këshillës, lutjes, ftesës, grishjes etj. Ato shprehin kërkesën e folësit dhe orvatjen e tij për realizimin ose mosrealizimin e kësaj kërke.

Zakonisht fjalitë nxitëse shprehin një kërkesë që i drejtohet bashkëbiseduesit, po mund t'u drejtohet edhe të tjerëve, ku bën pjesë edhe folësi. Atëherë, përveç vetës së dytë, përdoret edhe veta tretë njëjës e shumës ose veta e parë shumës, si në shembujt e mëposhtëm:

Mos bëni zhurmë, - i porositi.

Uluni ju lutem.

Dilni që të dy pa zhurmë!

Mendohu mirë, po fol!

Le të ketë kujdes Bajamja.

- Të mblidhen të gjithë, - urdhëroi përgjegjësi.

- Le dëgjojmë tani, le t'i diskutojmë edhe problemet tona.

Fjalitë nxitëse shqiptohen me një intonacion të veçantë, i cili merr ngjyrimë melodike të ndryshme sipas karakterit të kërkesës që ato shprehin. Intonacioni dallon format kryesore të shfaqjes së vullnetit: dallohet *urdhëri* (sidomos urdhëri i prerë) nga *porosia* dhe *këshilla*, *nxitja* nga *propozimi e lutja*, *grishja* nga *pëlqimi* dhe *pranimi*.

4. Fjalitë pyetëse

Fjalitë pyetëse janë fjali në të cilat përmbahet një pyetje, pra, shërbejnë për të pyetur. Me anën e tyre folësi kërkon të mësojë diçka që nuk e di ose të sigurohet për vërtetësinë e një fakti. P.sh. :

- Po si është? Desha të them, të rri mendja vetëm aty? Çdo minutë, çdo sekondë? Kush përgjigjet për këtë?

Fjalitë pyetëse karakterizohen nga tipare dalluese të qarta fonetike, leksikore, morfologjike dhe sintaksore, siç janë

- intonacioni,
- fjalët pyetëse,
- rendi i fjalëve.

Intonacioni pyetës është tipar dallues kryesor në një fjali pyetëse. Ai nuk zbret në fund të fjalisë dëftore, por ngrihet. Roli i tij është i rëndësishëm në fjalitë që s'kanë mjete të tjera karakteristike për fjalitë pyetëse dhe kanë të njëjtën formë me fjalitë dëftore:

Ka ndodhur diçka?

S'i keni dëgjuar mitralozat?